

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL MALISHEVE**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **625-26-2637-2-1-1**

Sa i përket tenderit për **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	D.P.Z.,,Naimi"
NUI	600414320
Adresa	MALISHEVË
Vendi	MALISHEVË
Kodi postar	24000
Numri Telefonit	+38349717441
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	HAKI HOXHA
Adresa elektronike	haki.hoxha12@outlook.com
Data e parashtrimit të ankesës	08.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS

Autoriteti Kontraktues më datë: 24.04.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për procedurën: SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS, me nr: 2026/625-26-2637-2-1-1.

Me datë: 13.05.2026, ne kemi dorëzuar ofertat.

Me datë: 26.05.2026, AK ka publikuar Njoftim Vendimin e AK dhe Letrat Standarde.

Në bazë të vendimit të datës: 26.05.2026, AK ka rekomanduar për Kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik IDEALI & GETI SH.P.K.; AUTOBUQA SH.P.K., Ismet Krasniqi pn., 24000, Malishevë, Kosovë.

Ne kemi kërkuar qasjen në ofertën e OE të rekomanduar. Meqense kemi dyshuar se GOE I rekomanduar kanë ofruar çmime Jo normalisht të ulëta, kemi analizuar ofertën e GOE të rekomanduar. Ende pa I analizuar çmimet jo normalisht të ulëta të GOE të rekomanduar, kemi vërejtur që AK nuk e ka vlerësuar ofertën e GOE të rekomanduar në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga

AK gjate kontestit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne si Oe kemi dorezuar kerkesen per rishqyrtim me date: 01.06.2026

AK, me date:04.06.2026 na ka refuzuar kerkesen per rishqyrtim

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

Neni 28 Specifikimet teknike

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK:

Neni 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës

Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëveve

Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues Tenderëveve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Autoriteti Kontraktues më datë: 24.04.2026, ka publikuar Njoftimin për Kontratë dhe dokumentet e tenderit për procedurën: **SERVISIMI DHE MIRËMBAJTJA E AUTOMJETEVE**

ZYRTARE TË KOMUNËS SË MALISHEVËS, me nr: 2026/625-26-2637-2-1-1.

Me datë: 13.05.2026, ne kemi dorëzuar ofertat.

Me datë: 26.05.2026, AK ka publikuar Njoftim Vendimin e AK dhe Letrat Standarde.

Në bazë të vendimit të datës: 26.05.2026, AK ka rekomanduar për Kontratë: Grup i Operatorëve Ekonomik IDEALI & GETI SH.P.K.; AUTOBUQA SH.P.K., Ismet Krasniqi pn.,

24000, Malishevë, Kosovë.

Ne kemi kërkuar qasjen në ofertën e OE të rekomanduar. Meqense kemi dyshuar se GOE I rekomanduar kanë ofruar çmime Jo normalisht të ulëta, kemi analizuar ofertën e GOE të rekomanduar. Ende pa I analizuar çmimet jo normalisht të ulëta të GOE të rekomanduar, kemi vërejtur që AK nuk e ka vlerësuar ofertën e GOE të rekomanduar në përputhje me nenin 59 të LPP-së.

Me date: 01.06.2026 kemi bërë kërkesë për rishqyrtim, por AK nuk ka marr parasysh pretendimet ankimore dhe me datë: 05.06.2026, na ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

SHKELJET E KONSTATUARA

1. Mosrespektimi i dosjes së tenderit dhe ndryshimi i dokumentit të përgatitur nga Autoriteti Kontraktues

Gjatë shqyrtimit të ofertës së GOE të rekomanduar kemi konstatuar se operatori ekonomik ka ndërhyrë në dokumentin "Specifikacioni i Servisimit dhe Mirëmbajtjes (Përshkrimi i Çmimeve)", i cili është pjesë integrale e dosjes së tenderit dhe është përgatitur nga Autoriteti Kontraktues.

Në disa pozicione të paramasës, ku Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar shprehimisht se nuk aplikohen çmime (N/A), operatori ekonomik ka vendosur çmime.

Njëkohësisht, në pozicione ku operatori ekonomik ka qenë i obliguar të ofrojë çmime sipas përshkrimit të AK-së, ai ka vendosur shenjën "N/A", duke mos ofertuar fare për ato pozicione.

Me këtë veprim, GOE i rekomanduar ka ndryshuar përmbajtjen e dokumentit të tenderit dhe nuk i është përmbajtur specifikimeve teknike dhe përshkrimit të çmimeve të përcaktuara

nga Autoriteti Kontraktues.

Te bashkangjitur keni Dëshmine (Deshmia 1 Versioni i krahasimit) në të cilën po paraqesim disa prej fakteve ku është ndërhyrë në paramasë, ndërsa gabimet kryesisht janë te PJESA B-Lista e pjeseve reserve dhe nuk kufizohen vetem ne keto qe po I bashkangjesim sepse ka shume pozicione qe eshte ndërhyrë.

Pra për ta elaboruar deshmine (tabelën) e bashkangjitur gjeni sqarimet si në vijim:

Në përshkrimin e çmimeve, të Pjesa B-Lista e pjesëve Rezerv, për Mjetin: QKMF Traktor Tafe S325 diesel, në pozicionet 6 dhe 7 AK ka kërkuar që OE të vendosin çmimet. Ndërsa

GOE I rekomanduar, ka vendosur shënjën N/A dhe nuk ka ofruar fare çmim.

Kjo është në kundërshtim me nenin: Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve I Rregullorës për prokurim public 001/2022, pika 40.16 (b):

40.16 Në rast se OE, ofron çmimin me 0.00 Euro për një artikull/pozicion të veçantë mund të ketë arsye të ndryshme dhe për këtë arsye nevojitet që të dërgohet një pyetje sqaruese tek Operatori Ekonomik duke kërkuar shpjegim për pozicionin 0.00 Euro.

b. Nëse Operatori Ekonomik thotë se ky artikull është ofruar falas, tenderi duhet të refuzohet pasi që dhuratat nuk janë të pranueshme.

Në përshkrimin e çmimeve, të Pjesa B-Lista e pjesëve Rezerv, për mjetin: QKMF Gjeneratori 120 KË, në pozicionin nr.11, AK ka kërkuar që OE të MOS vendosin çmim, sepse e ka vendosur shënjën N/A. Ndërsa GOE i rekomanduar, e ka shlyer këtë shënjë dhe ka vendosur çmim !. Pra Oe ka ndërhyrë në paramasën të cilën e ka publikuar AK në dokumentet e tenderit dhe I njëjti ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 të LPP-së.

Po ashtu të bashkangjitur keni përshkrimin e çmimeve (Deshmia 2 oferta e GOE të rekomanduar), se si i ka ofruar çmimet GOE në kundërshtim me dokumentet e tenderit të publikuara nga AK.

2. Shkelja e Nenit 28 të LPP-së

Neni 28 i LPP-së përcakton se specifikimet teknike duhet të respektohen nga operatorët ekonomikë dhe se ofertat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktues.

Duke ndryshuar dokumentin e përshkrimit të çmimeve dhe duke zëvendësuar pozicionet e kërkuara me "N/A", GOE i rekomanduar nuk ka ofertuar sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe ka paraqitur ofertë që devijon nga kërkesat e Autoritetit Kontraktues.

3. Shkelja e Nenit 59 të LPP-së nga Autoriteti Kontraktues

Sipas nenit 59 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar të shqyrtojë, vlerësojë dhe krahasojë ofertat vetëm në bazë të kriterëve dhe kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Përkundër faktit se GOE i rekomanduar ka ndryshuar dokumentin e përshkrimit të çmimeve dhe nuk ka ofertuar në përputhje me formatin dhe kërkesat e përcaktuara nga AK, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar ofertën e tij si të përgjegjshme dhe e ka

rekomanduar për kontratë.

Kjo dëshmon se AK nuk ka bërë vlerësim të duhur të ofertës financiare dhe nuk ka verifikuar përputhshmërinë e saj me kërkesat e dosjes së tenderit, duke vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP-së.

4. Oferta e GOE të rekomanduar është ofertë e papërgjegjshme

Meqenëse operatori ekonomik nuk ka plotësuar të gjitha pozicionet sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe ka ndryshuar dokumentin standard të përshkrimit të çmimeve, oferta e tij nuk mund të konsiderohet ofertë e përgjegjshme.

Prandaj, e njëjta është dashur të refuzohej gjatë fazës së vlerësimit administrativ dhe financiar.

Po ashtu AK ka bërë shkelje të nenit Neni 63 Vendimi i Autoritetit Kontraktues të Rregullorës për prokurim public 001/2022, sepse I njëjti pas kërkesës për rishqyrtim, ka mundur të korigjojë gabimin e bërë gjatë fazës së vlerësimit, por quditërisht ka vazhduar duke na refuzuar kërkesën për rishqyrtim edhe pse ne si OE ankues ua kemi bërë të kjashtë shkeljet ligjore që kanë ndodhur në fazën e vlerësimit.

Duke u bazuar në faktet dhe shkeljet e lartcekura, kërkojmë nga Organi Shqyrtues I Prokurimit, që: të aprovojë ANKESËN si të bazuar, të anulojë Njoftimin mbi Vendimin e AK-së të datës 26.05.2026. Gjithashtu kërkojmë që OSHP të detyrojë AK të rivlerësojë ofertat në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit, e me këtë rast të eliminojë nga procedura ofertën e GOE IDEALI & GETI SH.P.K. dhe AUTOBUQA SH.P.K., për shkak se oferta e tyre nuk është në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit dhe për rrjedhojë është ofertë e papërgjegjshme dhe të na shpall ne fitues të kësaj procedure si OE i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkelja e supozuar ka ndikuar drejtpërdrejt në krijimin e dëmeve materiale për kompaninë tonë, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe duke sjellë elemente të diskriminimit në këtë procedurë. Si pasojë, ne jemi të detyruar të përballojmë kosto shtesë, përfshirë shpenzimet administrative dhe financiare që lidhen me përgatitjen dhe zhvillimin e procedurës së ankesës. Këto kosto shtesë përfaqësojnë barrë të panevojshme për operatorin ekonomik dhe dëmtojnë pozitën tonë konkurruese në treg.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*